

URDHËR
Nr. 424, datë 16.10.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË CERTIFIKATËS SË
CILËSISË PËR PËRPUTHSHMËRINË E PRODUKTIT BUJQËSOR OSE USHQIMOR
ME SPECIFIKIMET TEKNIKE TË PRODUKTEVE TË REGJISTRUARA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 26, të ligjit nr. 8/2019, datë 26.2.2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural,

URDHËROJ:

1. Përcaktimin e formatit dhe përmbajtjes së certifikatës së cilësisë, për përputhshmërinë e produktit bujqësor ose ushqimor me specifikimet teknike të produkteve të regjistruara si specialitet tradicional i garantuar (STG), tregues gjeografik i mbrojtur (TGJM) dhe emërtim origjine i mbrojtur EOM”, sipas aneksit 1, bashkëlidhur.

2. Termat (përmbajtja) e përdorur në certifikatën e cilësisë, kanë kuptimin si më poshtë:

- a) emri dhe mbiemri i operatorit të prodhimit;
- b) adresa e operatorit të prodhimit;
- c) emri i produktit bujqësor ose ushqimor;
- ç) kategoria e produktit bujqësor ose ushqimor,

do të jenë të njëjtë me të dhënat e deklaruara nga aplikanti në formatin e aplikimit të produktit bujqësor ose ushqimor;

d) sasia e prodhimit e deklaruar nga operatori ushqimor gjatë periudhës së vlefshmërisë së certifikatës do të jetë sasia e prodhimit që operatori ka gjendje për treg, në momentin e kryerjes së kontrollit zyrtar;

dh) periudha e vlefshmërisë së certifikatës do të jetë vjetore, bazuar në kontrollet zyrtare sipas analizës së riskut.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

ANEKS 1

Aneksi 1

 				
CERTIFIKATË CILËSIE Konfirmohet përputhshmëria e procesit të prodhimit të produkteve bujqësore ose ushqimore me specifikimet teknike				
Emri dhe Mbiemri i operatorit të prodhimit:				
Adresa operatorit të prodhimit:				
Emri i produktit bujqësor ose ushqimor:				
Kategoria e produktit bujqësor ose ushqimor				
Sasia e prodhimit e deklaruar nga operatori ushqimor gjatë periudhës së vlefshmërisë së certifikates:				
Periudha e vlefshmërisë së certifikates:				
Bazuar në rezultatet e kontrollit të përputhshmërisë së prodhimit të produktit bujqësor ose ushqimor, me specifikimet teknike të përcaktuara në regjistër, referuar nenit 15, të ligjit nr. 8/2019 datë 26 Shkurt 2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, Konfirmohet që: Produkti _____ është <table style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <td>SPECIALITET TRADICIONAL / I GARANTUAR</td> <td>TREGUES GJEOGRAFIK / I MBROJTUR</td> <td>EMËRTIM ORIGJINE I MBROJTUR</td> </tr> </table>   		SPECIALITET TRADICIONAL / I GARANTUAR	TREGUES GJEOGRAFIK / I MBROJTUR	EMËRTIM ORIGJINE I MBROJTUR
SPECIALITET TRADICIONAL / I GARANTUAR	TREGUES GJEOGRAFIK / I MBROJTUR	EMËRTIM ORIGJINE I MBROJTUR		